



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.10.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 15 tetor 2018.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi – Shqipëri, alokimet e vitit 2016”.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj (Republika e Shqipërisë) – Skje (Mali i Zi) për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në Liqenin e Shkodrës”.
4. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Bashkimit European për bashkëpunimin e zbatimit të ligjit për vendosjen e oficerit ndërlidhës të Europolit”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Andrea Marto, Ervin Bushati, Adnor Shameti, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Evis Kushi, Elona Gjebrea dhe Ilir Xhakolli.

Mungojnë:

Tritan Shehu, Klajda Gjoshja, Edi Paloka, Nard Ndoka, Klevis Balliu, Rudina Hajdari dhe Edmond Panariti.

Të ftuar:

Genti Cakja – Zëvendësministër për Europën dhe Punët e Jashtme

Danjela Çekani – Drejtoreshë e Fondeve IPA në Ministrinë për Europën dhe Punët e
Jashtme

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e sotme të Komisionit për Politikën e Jashtme me këtë rend dite: miratimin e procesverbalit të datës 15.10.2018, diskutimin dhe miratimin e projektligjeve “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi - Shqipëri, alokimet e vitit 2016”; “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj (Republika e Shqipërisë) – Skje (Mali i Zi) për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në Liqenin e Shkodrës”, si dhe të atij “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Bashkimit European për bashkëpunimin e zbatimit të ligjit për vendosjen e oficerit ndërlidhës të Europol-it”.

Ka vërejtje nga kolegët lidhur me procesverbalin e datës 15.10.2018? Nuk ka.

E konsiderojmë të miratuar.

Fillojmë me shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi – Shqipëri, alokimet e vitit 2016”.

Të ftuar për këtë projektligj nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme kemi zotin Genti Cakja, zëvendësministër, dhe zonjën Danjela Çekani, drejtore e fondeve të IPA-s.

Zoti Zëvendësministër, fjala është për ju, për një prezantim të shkurtër të projektligjit.

Genti Cakja – Faleminderit shumë!

Qëllimi i projektaktit është ratifikimi i marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Malit të Zi dhe Komisionit European për alokimet e vitit 2016 për asistencën financiare për bashkëpunimin ndërkufitar.

Për t’ju kursyer prej leximit të dokumentit, unë po fokusohem në tre aspekte esenciale, të cilat janë të rëndësishme për të pasur vëmendjen tuaj.

Elementi i parë është korniza ligjore. Marrëveshja e financimit është miratuar tashmë nga ana e Këshillit të Ministrave nëpërmjet vendimit nr. 798, datë 29.12.2017, ku në të njëjtën

ditë është nënshkruar edhe nga pala shqiptare, e përfaqësuar nga ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, zoti Ditmir Bushati.

Elementi i dytë, që meriton vëmendjen tuaj, është efekti financiar i marrëveshjes. Bëhet fjalë për një shumë të përgjithshme prej 1,7 milionë, e cila do të plotësohet me kontributin e përbashkët të qeverisë së Malit të Zi dhe asaj të Shqipërisë prej 300 mijë eurosh. Pra, buxheti për vitin 2016 do të jetë 2 milionë.

Elementi i tretë është efekti i kësaj marrëveshjeje lidhur me benefitet specifike që do të derivojnë nga kjo marrëveshje. Përfituese të projekteve të mundshme nga ana e Malit të Zi do të jenë 10 njësi territoriale, ndërkaq nga pala shqiptare përfituese të projekteve do të jenë dy qarqe kryesore, qarku i Shkodrës dhe ai i Lezhës.

Në fund, prioriteti i këtyre projekteve është përcaktuar nga vlerësimi i bërë me ndërmjetësimin e Komisionit European që në vitin 2014 dhe, sipas konkluzave të ekspertëve, prioritet të posaçëm duhet të kenë fushat, si nxitja e turizmit, mbrojtja e mjedisit, përfshirja sociale dhe lëvizja e punonjësve. Pra, projekte të cilat do të jenë të hapura për aplikacione pas miratimit të alokimeve financiare për vitin 2016 do të jenë të ndërlidhura ekskluzivisht me këto tri fusha.

Për çdo përgjigje teknike ose për çdo interes të veçantë lidhur me materien që unë e shpalosa, mbetem në dispozicionin tuaj për përgjigje shtesë, gjithnjë duke llogaritur edhe ndihmën e drejtoreshës së fondeve të IPA-s në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, zonjës Danjela Çekani. Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Zëvendësministër!

Keni qenë realisht shterues në atë që keni thënë, ndaj ju falënderoj edhe për respektimin e kohës dhe thënien e gjërave që duhet!

Besoj se ne kemi konsumuar në mbledhjen tonë të mëparshme të Komisionit për Politikën e Jashtme procedimin lidhur me fondet IPA në përgjithësi, në mënyrë të veçantë për fondet IPA II, madje jemi sqaruar edhe nga zonja drejtoreshë lidhur me këtë proces.

E ritheksoj, të gjitha këto projektligje për ratifikim kalojnë nga komisionet parlamentare respektive, sepse sado, në një formë të reduktuar parash, gjithsesi për t'u konsideruar, këto fonde IPA suportohen nga buxheti i shtetit, pra kontribuon edhe buxheti i shtetit lidhur me këtë gjë, ndaj edhe diskutimi kalon në parlament.

Kam për të bërë thjesht një koment dhe pastaj i ftoj kolegët të kalojmë në pyetje ose diskutime lidhur me projektligjin, sipas dëshirës.

Përgjithësisht, ai rajon ka realisht nevojë për këto para dhe për një zhvillim të mëtejshëm. Besoj se Liqeni i Shkodrës mbetet nga të dyja anët e liqenit një liqen me një histori të lavdishme të kahershme të Shqipërisë dhe shqiptarëve që jetojnë në trevat e tyre. Kështu që, nuk mbetet gjë tjetër veçse ta përgëzoj Komisionin European, sigurisht edhe qeverinë e Republikës së Shqipërisë dhe atë malazeze për këtë angazhim, madje shpresoj që këto fonde të përdoren në mënyrën më të mirë të mundshme.

Kush e do fjalën?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, deputeti Marto...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më është thënë se duhet të preçizoj emrin për arsye regjistrimi.

Andrea Marto – Kjo është një marrëveshje e ngjashme me atë që kemi kaluar më parë në komision. Unë nuk dija gjë për këtë, por informacionin e dua thjesht për të ditur sa të suksesshëm kemi qenë në thithjen e fondeve të akorduara në kuadër të IPA-s gjatë viteve të shkuara, jo vetëm për marrëveshjet e fundit.

Mimi Kodheli – Unë mendoj se një informacion ka ardhur pranë komisionit tonë dhe tërheq vërejtje në qoftë se informacioni nuk u është shpërndarë të gjithë deputetëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pse? Për ç' meritë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, u tërheq vërejtje të gjithë asistentëve të komisionit, pasi informacioni duhet të ishte shpërndarë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, duhet të ishte shpërndarë! Kaq e thjeshtë është.

(Këshilltari i komisionit ndërhyr pa mikrofon.)

Sepse një informacion i tillë, siç edhe e kërkuam, ka ardhur.

E hedhim në votim projektligjin. Kush është dakord në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votim nen për nen projektligjin.

Neni 1, ratifikimi i marrëveshjes. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ju falënderoj, zoti Zëvendësministër, dhe ju uroj punë të mbarë!

Genti Cakja – Shumë faleminderit, zonja kryetare!

Ju uroj gjithë të mirat!

Mimi Kodheli – Me të mira! Faleminderit!

Sekretare
Elona Hoxha

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit
Ina Jano



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.10.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj (Republika e Shqipërisë) – Skje (Mali i Zi) për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në Liqenin e Shkodrës”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Andrea Marto, Ervin Bushati, Adnor Shameti, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Evis Kushi dhe Ilir Xhakolli.

Mungojnë:

Tritan Shehu, Klajda Gjoshaj, Edi Paloka, Nard Ndoka, Klevis Balliu, Rudina Hajdari dhe Edmond Panariti.

Të ftuar:

Rovena Voda – Zëvendësministre e Brendshme

Drejtues i Parë Xhevahir Karaj – Drejtor i Drejtorisë së Kufirit në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin në Ministrinë e Brendshme

Anisa Boçi – Specialiste në Drejtorinë Juridike pranë Departamentit për Shërbimet Mbështetëse në Ministrinë e Brendshme

Mimi Kodheli – Mirë se vini, të nderuar zëvendësministra!

Sipas rendit të ditës, tani kemi për diskutim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj (Republika e Shqipërisë) – Skje (Mali i Zi) për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në Liqenin e Shkodrës”.

Të pranishëm kemi dy zëvendësministtrat e Brendshëm, zonjën Rovenë Voda dhe zotin Besfort Lamallari, si dhe Drejtuesin e Parë, zotin Xhevahir Karaj, drejtor i Drejtorisë së Kufirit në Departamentin e Kufirit dhe të Migracionit po nga Ministria e Brendshme.

Mirë se vini në komision!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam një Kryekomisar në listë dhe një specialist. Janë prezent?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk janë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë prezentë? Ah, më falni! Përsëritet!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Drejtor, patjetër, mund të uleni, ndërkohë që ju të medieve mund të çoheni në këmbë. Shumë faleminderit prej jush!

(Diskutime në sallë)

Është edhe drejtori i Europolit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zotëri, ju mund të merrni një karrige dhe të uleni aty. Nuk besoj se përbën problem të rri aty përballë deputetëve.

Jeni Kryekomisar Rexhepi, shefi i Zyrës Kombëtare të Europol-it, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, mirë se vini, zoti Kryekomisar Shkëlzen Rexhepi!

Fillojmë me prezantimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj (Republika e Shqipërisë) – Skje (Mali i Zi) për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në Liqenin e Shkodrës”.

Zonja Voda, fjala është për ju.

Rovena Voda – Faleminderit, zonja kryetare e komisionit!

Projektligji që keni përpara për diskutim, siç e përmendët edhe ju, pra ai “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj (Republika e Shqipërisë) – Skje (Mali i Zi) për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në Liqenin e Shkodrës” vjen, në fakt, në kuadër të përmbushjes së prioriteteve të qeverisë shqiptare për lehtësimin e lëvizjes së lirë të shtetasve dhe të mjeteve e mallrave në këtë zonë.

Në fakt, unë dua të sqaroj se ky projektligj ka ardhur fillimisht si një kërkesë e komunitetit shqiptar, e banorëve shqiptarë, të zonës së malësisë së Tivarit, pra në pjesën e Malit të Zi, por pasi është bërë edhe një vlerësim nga autoritetet shqiptare, kryesisht nga Departamenti i Kufirit dhe Migracionit, sigurisht që edhe pjesa tjetër e banorëve që prekin kryesisht pjesën e Shirokës, Liqenit të Shkodrës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, prek liqenin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Siç po thosha, edhe kjo zonë është parë me shumë interes dhe patjetër do t’u shërbejë si lehtësimi të lëvizjes së qytetarëve në të dyja anët e kufirit, ashtu edhe mjeteve dhe shkëmbimit të mallrave.

Kjo vjen, në fakt, edhe si rezultat i një eksperience shumë të mirë, do të thosha unë, e një pike tjetër të përbashkët kufitare, që ne e kemi pasur me Malin e Zi, po e përmend këtu pikën e përbashkët të kalimit kufitar të Muriqanit, pikë e hapur që në vitin 2008. Natyrisht, impakti dhe implementimi i këtij projekti në gjithë këto vite ka dhënë rezultate shumë të mira në lehtësimin e qarkullimit në të dyja anët e kufirit, prandaj edhe kjo pikë e përbashkët kufitare, ku e veçanta e saj qëndron pikërisht në faktin se prek edhe zonën liqenore të Liqenit të Shkodrës, do të jetë si një model i ngjashëm i pikës kufitare të përbashkët të Muriqanit. Sigurisht, kjo do të ndihmojë edhe për sa i përket rritjes dhe zhvillimit të turizmit të kësaj zone, duke intensifikuar dhe lehtësuar lëvizjen e pasagjerëve, të qytetarëve të asaj zone, si dhe të mallrave. Natyrisht, janë bërë diskutime edhe në nivel ekspertësh, duke mos harruar këtu që kemi edhe pjesën e doganës, pra janë përfshirë edhe përfaqësuesit e shërbimit doganor të të dyja palëve, policitë e shtetit respektivisht, por edhe ekspertë të tjerë, qoftë edhe të mjedisit për sa i takon impaktin që mund të ketë në mjedis, në mënyrë që të arrihet në dakordësinë ndërmjet të dyja qeverive për ta hapur këtë pikë të përbashkët të kalimit kufitar.

Sigurisht, të dyja palët do të kenë në mënyrë proporcionale detyrimet dhe të drejtat e tyre për sa i përket investimit në infrastrukturë apo edhe në mjete dhe në logjistikë të kësaj pike

kufitare, e cila, dua ta sqaroj, do të hapet në anën e Malit të Zi. Patjetër do të ketë investime në infrastrukturë. Është një pjesë rruge prej 1,5 kilometrash, e cila, në fakt, është një rrugë e vjetër, por ku do të investohet dhe do të bëhet e re, për ta çuar deri në këtë pikë kalimin kufitar.

Për sa i përket pjesës liqenore, do të shfrytëzohet një mol, që është në anën malazeze, i cili kërkon thjesht një rikonstruksion, por aty do të jetë vend-bazimi i mjeteve.

Siç e thashë, e gjitha kjo bazohet në një eksperiencë shumë të mirë që ne kemi me pikën e përbashkët kufitare të Muriqanit, e cila ndodhet në kufirin tonë tokësor. Pra, Muriqani, pika e përbashkët është në kufirin e republikës (domethënë brenda territorit), ndërsa Zogaj ose Skje (nga ana e tyre) do të jetë një pikë e përbashkët e kalimit kufitar, por që do të jetë në anën e Malit të Zi.

Për sa i përket zërit të investimeve, ai do të përfshihen në zërin e buxhetit të Policisë së Shtetit.

Patjetër, do të respektohet ligji për kontrollin ndërkufitar, meqë është pikë e përbashkët kufitare me një hyrje dhe me një dalje. Besoj se kjo do të shërbejë edhe në eficiencën më të mirë të burimeve njerëzore, meqenëse kontrollet, hyrjet dhe daljet do të jenë të përbashkëta. Kaq kisha. Faleminderit!

Mimi Kodheli – Dakord.

Shpresoj që në buxhetin që po diskutohet, të mund të ketë një zë edhe për rregullimin një kilometër e gjysmë rruge, që të çon deri në pikën kufitare, në mënyrë që edhe pamja, edhe shërbimi për qytetarët, për bizneset dhe për turistët të jetë dinjitoz, siç është kjo marrëveshje.

Unë di që është një pikë komunikimi shumë e vjetër, të cilën thjesht e kemi rivitalizuar. Unë ju komplimentoj për idenë e kahershme të marrë, sepse dikur aty komunikohesh dhe tregtohej. Kur them dikur, flas për shekuj më parë, jo për dje.

Ka pyetje dhe komente nga kolegët?

Urdhëroni!

Rovena Voda – Nga ana tjetër, në lidhje me atë që ju thatë, moli nga ana tjetër, është një mol mbi 100-vjeçar. Kjo tregon historinë e lashtë të marrëdhënies midis dy territoreve dhe dy popullsive. Ne sot po vijmë me këtë projekt për ta rivitalizuar atë. Faleminderit!

Mimi Kodheli – Fjalën e ka zëvendëskryetarja, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja kryetare e komisionit!

Falënderoj të ftuarit për prezantimin e këtij projektligji dhe për nismën e marrë për të lehtësuar lëvizjen e lirë të njerëzve, të mallrave dhe të shërbimeve me një vend fqinjë.

Unë kam 2 pyetje. Kjo është një marrëveshje e miratuar në parim, e cila nuk detajon afatet, se kur do të hapet pika dhe masat që do të merren, sepse gjithçka do të vendoset nga një komision i përbashkët, siç thuhet në relacion.

A ka ndonjë studim se kur do të jetë e gatshme se kur do të vihet në shfrytëzim kjo pikë e hapjes?

Pyetja e dytë: në relacion thuhet se do të lejohet kalimi dhe qarkullimi ndërkombëtar jo vetëm i njerëzve, por edhe i mallrave. Ju sapo thatë që në anën tjetër të kufirit kemi një mol 100-vjeçar, ndërsa në anën tonë, nuk besoj se kemi ndonjë mol të gatshëm. Në këtë kuadër, a do të jetë kjo pikë që në fillim për kalimin e njerëzve, të pasagjerëve nëpërmjet përdorimit të liqenit apo do të jetë edhe për shërbime të tjera, si për shembull transporti ndërkombëtar i mallrave? Faleminderit!

Mimi Kodheli - Fjalën e ka zonja Voda!

Rovena Voda – Faleminderit për pyetjet, zonja Hysi!

Është e qartë edhe nga prezantimi që unë bëra, se kjo pikë do të shërbejë për lëvizjen jo vetëm të qytetarëve, pra të pasagjerëve dhe mjeteve, por edhe të mallrave. Në negociatat dypalëshe kanë qenë përfaqësues edhe të shërbimit doganor, edhe të doganave. Besoj se do të jetë një pikë e përbashkët e kalimit kufitar, sipas të gjitha standardeve, pra jo vetëm për pasagjerët dhe për mjetet, por edhe për pjesën e mallrave, pra për regjimin doganor.

Për sa i përket pjesës liqenore, pse e përmenda molin dhe pse thashë se kjo pikë kufitare do të jetë në pjesën e Malit të Zi? Siç do të jetë godina e pikës së kalimit kufitar, do të jetë edhe ajo e kalimit të pjesës së liqenit.

Unë përmenda Muriqanin, që është një pikë kufitare, që është tërësisht në territorin shqiptar. Në fakt, është një eksperiencë shumë e bukur, besoj se të gjithë kanë kaluar. Policët e policisë kufitare malazeze vijnë në territorin tonë, kur bëjnë kontrole të përbashkëta, por si pikë ajo ndodhet në territorin shqiptar. E njëjta gjë është edhe në këtë pjesë. Pra, do të jetë një godinë për kalimin tokësor, që do të jetë në territorin e Malit të Zi. Po ashtu, për pjesën liqenore do të jetë si qendër moli, që ndodhet në anën e Malit të Zi.

Megjithatë, duke parë relacionin, do të ketë edhe një komision, i cili do të vëzhgojë implementimin e këtij projekti. Kjo do të thotë që monitorimi i këtij projekti, nëse do të ketë nevojë për ndërhyrje në infrastrukturë apo për ta pasur atë në standardet e një pike të kalimit kufitar të vendeve të BE-së, pse jo, do të ndërhyhet.

Për sa i përket një afati, jam dakord me zonjën Hysi, që thotë se kjo është një marrëveshje në parim dhe nuk parashikohet në detaje, por për shkak se është një vullnet i

përbashkët i të dyja qeverive dhe meqë kërkesa inicuese ka qenë nga qeveria malazeze, ne besojmë se në vitin 2019, pasi të detajohen edhe shpenzimet për ndërhyrjet në infrastrukturë, në logjistikë dhe në burime njerëzore, themi se brenda vitit 2019 do të fillojë ndërtimi i kësaj pike. Faleminderit!

Mimi Kodheli - Faleminderit!

Besoj se nuk është e nevojshme të pyesim, nëse ju keni ndonjë informacion në lidhje me buxhetimin e Malit të Zi. Besoj se kjo do të jetë pjesë e bisedimeve të përbashkëta. Nëse nuk keni ndonjë kundërshtim, mendoj ta hedhim në votim.

Hedhim në votim në parim projektligjin.

Kush është dakord në parim? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim ky projektligj.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Kalojmë te neni 2.

Kush është dakord me këtë nen? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit!

Kush është dakord në tërësi me këtë projektligj? Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji.

Faleminderit për përgjigjet e pyetjeve dhe për sqarimet, zonja Voda!

Sekretare
Elona Hoxha

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit
Ina Jano



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.10.2018, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e komisionit

Rendi i ditës: Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Bashkimit European për bashkëpunimin e zbatimit të ligjit, mbi vendosjen e oficerit ndërlidhës të Europolit”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Andrea Marto, Ervin Bushati, Adnor Shameti, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Evis Kushi dhe Ilir Xhakolli

Mungojnë:

Tritan Shehu, Klajda Gjoshaj, Edi Paloka, Nard Ndoka, Klevis Balliu, Rudina Hajdari, Edmond Panariti.

Të ftuar:

Besfort Lamellari - Zëvendësministër i Brendshëm

Jeton Xoxa - Specialist i Sektorit të Bashkëpunimit, Marrëveshjeve dhe Kontratave në Ministrinë e Brendshme

Shkëlzen Rexhepi - Shefi i Zyrës Kombëtare të Europol-it

Mimi Kodheli- Kalojmë në diskutimin e projektligjit të fundit për sot, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Bashkimit European për bashkëpunimin e zbatimit të ligjit, mbi vendosjen e oficerit ndërlidhës të Europolit”.

Fjalën e ka zoti Lamellari, zëvendësministër i Brendshëm!

Besford Lamellari - Faleminderit, zonja kryetare e komisionit!

Përshëndetje, të nderuar deputetë!

Projektligji që vjen sot për miratim në këtë komision, është iniciuar nga Europol dhe është në përputhje të plotë edhe me çështjen që është diskutuar kohë më parë, po në këtë komision dhe në komisionet e tjera respektive, për shtimin e fushave të kompetencës dhe të bashkëpunimit mes Republikës së Shqipërisë dhe Europolit. Sot ka shumë më tepër hapësira bashkëpunimi në luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit, krimeve të rënda etj. në nivel european.

Ardhja përmes kësaj marrëveshjeje, e listës së oficerëve ndërlidhës të Europolit në Shqipëri, padyshim kontribuon dhe i jep një shtysë të mëtejshme luftës kundër krimit të organizuar. Krahas elementit operacional, i cili shënohet në rritje ndër vite, konkretisht deri në 31 gusht të këtij viti, janë shënuar 5961 mesazhe të shkëmbyera përmes kanalit SIENA me Europolin. Ka një rritje prej 15% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm. Megjithatë, ardhja e ekspertit të Europolit do të kontribuojë padyshim, në rritjen e informacioneve të shkëmbyera, por edhe në lehtësimin e kontakteve mes RSH-së, Europolit dhe vendeve anëtare të BE-së.

Në aspektin e dytë, atë politik, ardhja e ekspertit të Europolit, është një vlerë e shtuar, pasi përputhet plotësisht me vullnetin e qeverisë shqiptare për të luftuar krimin e organizuar dhe krimet e rënda pa dallim ngjyre apo çdolloj dallimi tjetër. Kjo është një luftë jo vetëm kundër krimit të organizuar, por edhe për sundimin e ligjit.

Shkëmbimi i informacioneve, takimet e përbashkëta dhe lehtësimi i komunikimeve mes Shqipërisë dhe vendeve anëtare të BE-së, është sigurisht, një tjetër vlerë, që i jep rëndësi të shtuar këtij projektakti.

Për sa u përket aspekteve logjistike, oficeri ndërlidhës i Europolit do të vendoset pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Ai do të gëzojë të njëjtat privilegje dhe imunitete, siç i gëzojnë të gjithë përfaqësuesit e tjerë të Trupit Diplomatik në Shqipëri. Ai përjashtohet nga detyrimet doganore, që janë për llogari të Europolit (për të gjitha pajisjet dhe mjetet që blihen dhe prokurohen nga Europol).

Marrëveshja përbëhet nga 9 nene, që përcaktojnë modalitetet e ndryshme. Kaq kisha në mënyrë të përmbledhur, zonja kryetare.

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Unë kam disa pyetje për ju. Çfarë shkëmbimesh ka pasur deri më sot Ministria e Punëve të Brendshme me Interpolin? Sa operacione të përbashkëta keni pasur deri sot?

Besfort Lamallari – Siç e përmenda, ka pasur një rritje të informacionit me 15% (të paktën ai që është përcjellë nga Policia e Shtetit për mesazhet e shkëmbyera me Europolin). Në vitin e kaluar ka pasur 15 % rritje, apo e përkthyer në vlerë numerike, kanë qenë rreth 6000 mesazhe të shkëmbyera deri më 31 gusht 2018. Ka pasur edhe disa operacione të koordinuara nga Europol. Një ndër më të suksesshmit ka qenë *Warning by land*, ku u proceduan rreth 51 persona dhe u arrestuan 39 persona të përfshirë në kontrabandë migrantësh, të cilët transportonin në mënyrë klandestine shtetasit shqiptarë drejt vendeve të ndryshme të BE-së, përfshirë Mbretërinë e Bashkuar dhe më pas Kanadanë, Amerikën etj.

Nëse ka nevojë për më shumë detaje, po ia kaloj fjalën përfaqësuesit nga Policia e Shtetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përveç operacioneve të përbashkëta, të cilat zhvillohen nën...

Mimi Kodheli – I jap fjalën zotit Shkëlzen Rexhepi, kryekomisar, shef i Zyrës Kombëtare të Europolit!

Shkëlzen Rexhepi - Faleminderit!

Viti aktual njih një rritje domethënëse të bashkëpunimit me strukturat e Europolit, që është në vetvete një njësi policore koordinative. Nën koordinimin e kësaj njësie janë zhvilluar tashmë 8 operacione të përbashkëta, ku Shqipëria ka qenë pjesë.

Gjithashtu, kemi marrë mbështetjen operacionale të Europolit, si dhe furnizimin me projekte analitike dhe me profile analitike të analistëve të Europolit, në kuadër të operacioneve që Policia e Shtetit ka zhvilluar apo i ka në zhvillim e sipër. Aktualisht, ne jemi pjesë e 11 projekteve analitike të zhvilluara në Europol.

Presim të bëhemi pjesë edhe në dy projekte të tjera. Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Ka pyetje dhe komente nga kolegët, lidhur me ratifikimin e kësaj marrëveshjeje për të pasur një përfaqësues të Europolit? Ky oficer do të jetë pranë Ministrisë së Brendshme, pra do të vendoset pranë zyrës së Europolit?

Shkëlzen Rexhepi – Po, do të vendoset pranë Europolit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.

Mimi Kodheli – Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Faleminderit, për prezantimin!

Çfarë afati kohor ka prezenca e këtij oficeri dhe a ka pasur ndonjë periudhë, kur kemi qenë të pambuluar me këtë prezencë?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Urdhëroni, zoti Rexhepi për përgjigjet e pyetjeve!

Shkëlzen Rexhepi – Aktualisht, ne kemi prej vitit 2010 një oficer në Europol. Nga kjo periudhë e këtij, prezenca e policisë shqiptare në Europol ka qenë gjithnjë e mbuluar. Kjo marrëveshje sjell risi, sepse vendoset një oficer i Europolit pranë Policisë së Shtetit, gjë që do të lehtësojë komunikimin.

Për sa i përket afatit, Europol është pala kontraktuese me oficerin, të cilin do të dërgojë. Marrëveshja është me afat të pakufizuar. Modalitetet e kontraktimit të oficerit janë ndërmjet personit, i cili do të emërohet në Shqipëri dhe Europolit.

Europol, në dijeninë time, e ka mbyllur procesin e rekrutimit të oficerit, pritet vetëm ratifikimi i marrëveshjes dhe pas kësaj, oficeri do të jetë operacional pranë nesh.

Mimi Kodheli – Faleminderit për prezantimin!

Nëse nuk keni pyetje apo diskutime të tjera, mendoj ta hedhim në votim këtë marrëveshje.

Hedhim në votim në parim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Bashkimit European për bashkëpunimin e zbatimit të ligjit, mbi vendosjen e oficerit ndërlidhës të Europol-it”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Kush është dakord në parim? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim ky projektligj.

Faleminderit!

Kalojmë në votimin nën për nën.

Neni 1.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Kalojmë te neni 2.

Kush është dakord me këtë nën? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit!

Kush është dakord në tërësi me këtë projektligj?

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji.

Faleminderit!

Punë të mbarë!

Ju falënderoj për prezencën!

MBYLLET MBLEDHJA